



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:122126
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05449807

C.nr.1157/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Dora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.O. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. M.Q. nga Prizreni, kundër të paditurit A.G. nga fshati Komuna Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.Th. nga Prizreni, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit material dhe jo material, jashtë seancës gjyqësore, më datë 14.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia me numër C.nr.1157/2021 e datës 16.06.2021, e paditësit A.O. nga Prizreni kundër të paditurit A.G. nga fshati Komuna Prizren, me objekt kontesti kompensimi i dëmit.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A.O. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij, av. M.Q. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me dt.16.06.2021 ka parashtruar padinë, kundër të paditurit A.G. me objekt të kontestit kompensimi i dëmit.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, palët ndërgjyqëse përmes të autorizuarve të tyre, av. M.Q. dhe av. A.Th. pranë kësaj gjykate me dt. 12.03.2024, kanë dorëzuar parashtrësën e përbashkët për tërheqje nga padia dhe kërkesëpadia, me ç ‘rast kanë theksuar se palët ndërgjyqëse në mes vete kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore. Paditësi ka theksuar se nuk ka interes juridik që të vazhdoj kjo çështje andaj, është tërhequr nga padia dhe kërkesëpadia dhe nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale. Ndërsa i padituri nuk e ka kundërshtuar tërheqjen nga kërkesëpadia dhe nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të konstatohet e tërhequr padia e paditësit, në përputhje me nenin 261 të LPK-së. Kështu, në nenin 261 par. 1 të LPK-së theksohet që *“Paditësi mund ta tërheq padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*. Pastaj, me nenin 261 par.2 të po këtij neni thuhet, *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*.

Numri i lëndës: 2021:122126
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05449807

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e saj procedurale.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 261 dhe 387 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1157/2021 të datës 14.03.2024

Gj y q t a r j a

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 261 par. 4 të LPK-së.